



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN**

Nr. 1082/1 prot.

Elbasan, më 9.10.2025

Lënda: Konfirmim akti.

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të ligjit Nr. 107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.82 datë 30.09.2025 ” Për shpalljen e zonave prioritare të zhvillimit në Bashkinë Librazhd” konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA



1082

11.10.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.01.10.2025

Nr.6691 prot

Nr.82 dt.30.09.2025

**"PËR SHPALLJEN E ZONAVE PRIORITARE TË ZHVILLIMIT NË BASHKINË
LIBRAZHD"**

Këshilli i Bashkisë Librazhd, bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, Ligjin nr.20/2025 "Për paketën e maleve", Udhëzimin nr.1, datë 19.06.2025 "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për dokumentacionin dhe procedurën e shpalljes së zonës prioritare të zhvillimit në territoret e bashkive" Këshilli Bashkiak i mbledhur sot me date 30.09.2025 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të miratojë shpalljen e disa zonave zhvillimore në Njësitë Administrative **Qendër, Stëbleve, Hotolisht, Polis, Orenjë dhe Lunik** si zona prioritare të zhvillimit në territorin e **Bashkisë Librazhd;**
2. Të miratojë **dokumentacionin** shoqërues si më poshtë:
 - a. Projektaktin e nënshkruar nga të gjithë anëtarët e grupit të punës;
 - b. Relacionin shoqërues, hartuar në përputhje me parashikimet e pikës 4, të këtij udhëzimi, që evidenton përmbushjen e të gjitha detyrave të grupit të punës.
 - c. Hartën e zonës së propozuar, sipas sistemit KRGJSH, të paraqitur mbi ortofoto (manual dhe digjital);
 - d. Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin kadastral (manual dhe digjital);
 - e. Hartën e zonës së propozuar, të pasuruar me informacionin e Planit të Përgjithshëm Vendor (manual dhe digjital);
 - f. Listën e aktiviteteve të mundshme/të synuara për zhvillim, bazuar në analizën e sektorëve me prioritet;
 - g. Dokumentacion që provon realizimin e konsultimeve paraprake me komunitetin lokal dhe palët e interesuara;
 - h. Të dhëna mbi praninë e poseduesve jopronarë brenda zonës së propozuar, statusin ligjor dhe kategorinë (klasifikimin) e pronës;
 - i. Raport mbi infrastrukturën ekzistuese dhe nevojat për investime infrastrukturore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë, grupi i punës dhe administrata e Bashkisë Librazhd;
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 55, pika 6 .

SEKRETARI I KËSHILLIT
Eelson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BIÇAKU

